



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 29

11 mars

2013

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 8/2013 datë 14.2.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8741, datë 15.2.2001 “Për sigurinë në punë në veprimtarinë minerare”.....	1177
Ligj nr. 9/2013 datë 14.2.2013	Për një ndryshim në ligjin nr. 10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”.....	1180
Ligj nr. 10/2013 datë 14.2.2013	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”.....	1181
Ligj nr. 11/2013 datë 14.2.2013	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, të ndryshuar.....	1183
Ligj nr. 12/2013 datë 14.2.2013	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.....	1185
Ligj nr. 13/2013 datë 14.2.2013	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8734, datë 1.2.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike”, të ndryshuar.....	1186
Ligj nr. 14/2013 datë 14.2.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9875, datë 14.2.2008 “Për metrologjinë”, të ndryshuar.....	1189
Ligj nr. 15/2013 datë 14.2.2013	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar.....	1193
Ligj nr. 16/2013 datë 14.2.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 480, datë 17.11.2011 “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”.....	1194

Ligj nr. 17/2013 datë 14.2.2013	Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”.....	1196
Ligj nr. 18/2013 datë 14.2.2013	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8681, datë 2.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”.....	1198
Ligj nr. 19/2013 datë 14.2.2013	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9290, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit”, të ndryshuar.....	1200
Ligj nr. 20/2013 datë 14.2.2013	Për disa ndryshime në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.	1201
Ligj nr. 21/2013 datë 14.2.2013	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar.....	1202
Ligj nr. 22/2013 datë 14.2.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar.....	1204
Ligj nr. 23/2013 datë 14.2.2013	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin në ndërtim”, të ndryshuar.....	1205
Ligj nr. 24/2013 datë 14.2.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9634, datë 30.10.2006 “Për inspektimin e punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës”.....	1206
Ligj nr. 25/2013 datë 14.2.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”.....	1209
Ligj nr. 26/2013 datë 14.2.2013	Për disa ndryshime në ligjin nr. 8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar.....	1210
Ligj nr. 27/2013 datë 14.2.2013	Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 469, datë 13.10.2011 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”.....	1212

LIGJ
Nr. 8/2013

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8741, DATË 15.2.2001 “PËR
SIGURINË NË PUNË NË VEPRIMTARINË MINERARE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8741, datë 15.2.2001 “Për sigurinë në punë në veprimtarinë minerare”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 2 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 3, 5 dhe 8 ndryshohen si më poshtë:

“3. “Inspektor” është punonjësi i kualifikuar, sipas kuptimit të termit të përdorur në ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë””.

“5. “Kontroll teknik” është inspektimi i organizuar në periudha të caktuara kohe dhe, kur del e nevojshme, jashtë këtyre periudhave, për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, sipas këtij ligji.”.

“8. “Inspektorati” kuptohet inspektorati përgjegjës që mbulon fushën minerare.”.

2. Pas pikës 8 shtohet pika 8/1 me këtë përmbajtje:

“8/1. “Struktura përgjegjëse” është struktura përgjegjëse për shpëtimin e minierave.”.

Neni 2

Në nenet 2, 7, 9, 12 dhe 18 pikat 3 e 4, emërtimi “Reparti i Inspektim-Shpëtimit të Minierave” dhe shkurtimi i këtij emërtimi “RISHM” zëvendësohen me emërtimin “Struktura përgjegjëse”.

Neni 3

Në nenet 4 shkronja “c”, 5, 13, 14 pika 1, 16, 18 pika 2 dhe 19, emërtimi “Reparti i Inspektim-Shpëtimit të Minierave” dhe shkurtimi i këtij emërtimi “RISHM” zëvendësohen me emërtimin “Inspektorati”.

Neni 4

Neni 6 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 6
Masat urgjente

1. Kur Inspektorati Shtetëror që mbulon fushën minerare vëren se një minierë ose karrierë rrezikon sigurinë e njerëzve dhe të mjedisit, me vendim të ndërmjetëm, sipas nevojave të rastit, merr masa urgjente, në përputhje me ligjin për inspektimin.

2. Kundër vendimit që vendos masa urgjente mund të bëhet ankim i veçantë në përputhje me ligjin për inspektimin.”.



Neni 5

Titulli i Kreut V bëhet “Inspektorati dhe struktura përgjegjëse”.

Neni 6

Në nenin 14 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit bëhet “Inspektorati”.

2. Pikat 2, 3 dhe 4 shfuqizohen.

3. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Organizimi dhe funksionimi i inspektoratit bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 7

Pas nenit 14 shtohet neni 14/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 14/1

Struktura përgjegjëse për shpëtimin e minierave

Organizimi dhe funksionimi i strukturës përgjegjëse për shpëtimin e minierave bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 8

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 15

Detyrat e strukturës përgjegjëse

Krahas detyrave në zbatim të kërkesave të neneve të parashikuara më sipër, struktura përgjegjëse kryen edhe këto detyra:

a) lëshon dëshmi për zjarrmëtarët dhe shpëtuesit e subjekteve private dhe publike;

b) detyra të tjera në përputhje me aktet nënligjore të miratuara në bazë dhe në zbatim të këtij ligji.”.

Neni 9

Pas nenit 15 shtohet neni 15/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 15/1

Detyrat e inspektoratit që mbulon fushën e minierave

Krahas detyrave në zbatim të kërkesave të neneve të parashikuara më sipër, inspektorati kryen edhe këto detyra:

a) bën regjistrimin e subjekteve që punojnë me leje minerare dhe lëndë plasëse;

b) mban regjistër për gjendjen teknike, për avaritë dhe aksidentet në miniera;

c) kryen inspektime në subjekte, private dhe publike, vendase dhe të huaja, që kryejnë veprimtari minerare në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për inspektimin.”.

Neni 10

Neni 16 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 16

Të drejtat e inspektorit dhe të strukturës përgjegjëse

1. Inspektori, kur vëren shkelje të dispozitave të këtij ligji dhe të rregulloreve, ka të drejtë që, krahas dënimeve kryesore administrative, të parashikuara në nenin 19 të këtij ligji, të vendosë një ose më shumë nga dënimet plotësuese, si më poshtë:

a) të urdhërojë kryerjen e detyrave të nevojshme, duke përcaktuar edhe afatet përkatëse për përmirësimin e gjendjes;

b) të pezullojë aktivitetin për një periudhë kohe të caktuar ose të pushojë përgjithmonë aktivitetin, sipas procedurës së parashikuar në shkronjën “c” të kësaj pike, kur gjykon se procesi teknologjik nuk garanton sigurinë në punë;

c) t’u propozojë organeve përgjegjëse heqjen e lejes minerare dhe të përdorimit të lëndës plasëse;

ç) për raste shkeljesh të rënda të rregulloreve të sigurimit teknik, me pasoja për jetën e njerëzve, të kërkojë ndjekje penale.

2. Struktura përgjegjëse dhe inspektorati bashkëpunojnë me shërbime përkatëse, publike ose private, për të kryer ekspertiza për krijimin e grupeve të punës dhe për kryerjen e kontrolleve të veçanta e të aksioneve të shpëtimit të njerëzve.”.

Neni 11

Neni 17 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 17

Burimet financiare

1. Burimet financiare të inspektoratit dhe strukturës përgjegjëse janë:

a) Buxheti i Shtetit;

b) të ardhurat me destinacion, që realizohen nga shërbimet për të tretët.

2. Inspektorati dhe struktura përgjegjëse realizojnë të ardhura nga shërbimet që kryejnë për subjektet private ose publike nga:

a) veprimtaria kryesore, sipas neneve 4, 5 dhe 12 të këtij ligji. Këto të ardhura derdhen në Buxhetin e Shtetit. Tarifat për këto të ardhura caktohen nga Ministria e Financave në bashkëpunim me ministrinë që mbulon veprimtarinë minerare;

b) të ardhurat me destinacion nga shërbimet për të tretët. Këto të ardhura derdhen në llogaritë përkatëse të inspektoratit dhe strukturës përgjegjëse dhe përdoren për mbulimin e shpenzimeve të kryera, ndërsa 10 për qind derdhen në Buxhetin e Shtetit. Tarifat për këto të ardhura caktohen nga ministria që mbulon veprimtarinë minerare në bashkëpunim me Ministrinë e Financave.”.

Neni 12

Pika 1 e nenit 18 shfuqizohet.

Neni 13

Në nenin 19 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Janë kundërvajtje administrative dhe dënohen me dënim kryesor me gjobë:



- a) shkeljet e dispozitave të neneve 3, 4, 5, 8, 10, 11 dhe 12 të këtij ligji, që rrezikojnë sigurinë e njerëzve, të kafshëve shtëpiake dhe të vlerave materiale;
 - b) shkeljet e përsëritura të konstatuara nga inspektori;
 - c) tejkalimi i afatit të lënë nga inspektori për mënjanimin e shkeljeve.”.
2. Paragrafi i dytë i pikës 2 ndryshohet si më poshtë:
“Inspektori që vëren shkeljen, harton procesverbalin dhe vendos gjobën, në përputhje me ligjin për inspektimin.”.
3. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:
“4. Shqyrtimi, marrja e vendimit përfundimtar dhe ankimi ndaj vendimit bëhen në përputhje me ligjin për inspektimin.”.
4. Pikat 5 dhe 6 shfuqizohen.

Neni 14

- Në nenin 20, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:
“1. Gjoha paguhet nga kundërvajtësit brenda 30 ditëve nga data kur vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afati, për çdo ditë vonese, paguhet një kamatë prej 2 për qind deri në një muaj. Kur edhe pas këtij afati gjoha nuk paguhet, atëherë zbatohet legjislacioni në fuqi për kundërvajtjet administrative.”.

Neni 15

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7967, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ

Nr. 9/2013

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 10 304, DATË 15.7.2010 “PËR SEKTORIN MINERAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, bëhet ndryshimi si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 2, pika 35 ndryshohet si më poshtë:

“35. “Strukturë përgjegjëse” është institucioni shtetëror, i përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, për të siguruar zbatimin e këtij ligji. Për qëllime dhe në funksion të veprimtarisë inspektuese, strukturë përgjegjëse do të nënkuptojë Inspektoratin Shtetëror përkatës, të caktuar në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. ”.

Neni 2

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7968, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ

Nr. 10/2013

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9947, DATË 7.7.2008 “PËR
PRONËSINË INDUSTRIALE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Kudo në ligj fjalët “Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut” zëvendësohen me fjalët “Inspektorati që mbulon fushën e mbikëqyrjes së tregut”.

Neni 2

Në nenin 199, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Çdo veprim i kryer në kundërshtim me përcaktimet e neneve 36, 127, 156 e 178 të këtij ligji, për shkelje të të drejtave të pronësisë industriale, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me dënim kryesor me gjobë nga 100 000 deri në 500 000 lekë. Gjobat vendosen nga inspektorati që mbulon fushën e mbikëqyrjes së tregut.”.



Neni 3

Pas nenit 199 shtohet neni 199/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 199/1 **Ankimi**

Ndaj vendimit të inspektoratit mund të bëhet ankim në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 4

Neni 200 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 200 **Kontrolli dhe mbikëqyrja e tregut të brendshëm**

1. Kontrolli për zbatimin e këtij ligji në tregun e brendshëm bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin nga inspektorati që mbulon fushën e mbikëqyrjes së tregut, pranë ministrisë përgjegjëse për tregtinë.

2. Organizimi dhe funksionimi i këtij inspektorati përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 5 **Dispozitë kalimtare**

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare

Miratuar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7969, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ
Nr. 11/2013

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8766, DATË 5.4.2001 “PËR
MBROJTJEN NGA ZJARRI DHE PËR SHPËTIMIN”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Kudo në ligj emërtimi “Ministria e Pushtetit Vendor” zëvendësohet me emërtimin “ministra përgjegjëse” dhe emërtimi “ministri i pushtetit vendor” zëvendësohet me emërtimin “ministri përgjegjës”.

Neni 2

Në nenin 1, pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore që burojnë nga ky ligj bëhet në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ky ligj.”.

Neni 3

Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 11

Formimi dhe trajnimi

Punonjësit e PMNZSH-së, krahas formimit dhe trajnimit në kurset pranë Shkollës së Mbrojtjes ndaj Zjarrit dhe në Qendrën e Trajnimit të Emergjencave Civile, u nënshtrohen detyrimisht edhe trajnimeve të tjera, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi në fushën e inspektimit.”.

Neni 4

Në nenin 38 bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

“1. Kur oficeri i inspektim-parandalimit të PMNZSH-së vëren shkelje administrative, për të cilat dispozitat e këtij ligji e ngarkojnë me këto detyra, ai vendos dënimin kryesor me gjobë. Sipas rastit, për të njëjtat shkelje mund të caktohen edhe dënimet plotësuese të “pezullimit” ose të “ndërprerjes së veprimtarisë”.

2. Në rast rrethanash të ngutshme, që e bëjnë të nevojshme marrjen e vendimit përfundimtar, aty për aty, në përfundim të inspektimit, oficeri i inspektim-parandalimit të PMNZSH-së, për shkeljet e



detyrimeve të parashikuara në nenin 25, mund të vendosë dënimin me gjobë nga 500 deri në 5 000 lekë. Në të njëjtat rrethana mund të caktohen edhe dënimet e tjera plotësuese.”.

2. Në pikën 3, fjalët “me vendim” hiqen.

3. Në pikën 4, fjalët “oficeri i PMNZSH-së” zëvendësohen me fjalët “oficeri i inspektim-parandalimit të PMNZSH-së”.

4. Pika 6 shfuqizohet.

Neni 5

Neni 39 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 39

Ankimi

Kundër vendimit të oficerit të inspektim-parandalimit të PMNZSH-së mund të bëhet ankimi, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative, në organin epror të PMNZSH-së, në ministrinë përgjegjëse. Kundër vendimit të organit epror të PMNZSH-së mund të bëhet ankimi në gjykatën kompetente, në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 6

Neni 40 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 40

Ekzekutimi

Ekzekutimi i gjobave dhe masave të tjera administrative, në zbatim të këtij ligji, bëhet sipas legjisllacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.”.

Neni 7

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletore Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7970, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ
Nr. 12/2013

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8450, DATË 24.2.1999 “PËR
PËRPUNIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGTIMIN E NAFTËS, TË GAZIT DHE
NËNPRODUKTEVE TË TYRE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Kudo në ligj emërtimi “Inspektorati Qendror Teknik” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati Shtetëror Përgjegjës”.

Neni 2

Në nenin 23 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Organi shtetëror, i specializuar për kontrollin e veprimtarisë së personave juridikë, të ushtruar në përputhje me dispozitat e këtij ligji, është Inspektorati Shtetëror Përgjegjës, që funksionon dhe varet nga ministri përgjegjës për hidrokarburet. Ky inspektorat mbështetet në kryerjen e funksioneve të tij nga laboratorë të akredituar për fushën dhe testet përkatëse. Këta laboratorë mund të jenë pjesë e këtij inspektorati ose jashtë tij. Për çdo rast testimi, duhet të ruhet fshehtësia e mostrës.”.

2. Paragrafi i katërt i pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

“- Kryerjen e analizave në laboratorët e akredituar, referuar në pikën 1 të këtij neni, për sasitë e importuara, para zhdoganimit, për sasitë e prodhuara në vend, si dhe për kontrollin periodik të detyrueshëm të tregut të brendshëm.

Shpenzimet për kontrollin e cilësisë përballohen nga vetë subjektet vetëm për rastin e futjes në territorin Republikës së Shqipërisë, në vlerën që caktohet nga ministri përgjegjës për hidrokarburet, ndërsa për rastet e tjera zbatohen rregullat e parashikuara në ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

3. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore bëhet në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për inspektimin.”.

Neni 3

Në nenin 25 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me dënim kryesor me gjobë dhe, sipas rastit, edhe me një ose disa dënime plotësuese, të përcaktuara në pikat 2.1 dhe 2.2 të këtij neni.”.



2. Paragrafi i dytë i nënndarjes “ii” të shkronjës “j” ndryshohet si më poshtë:

“ii) Masat urgjente, dënimi kryesor me gjobë dhe dënimet e tjera plotësuese jepen nga Inspektorati Shtetëror Përgjegjës.”.

3. Pas pikës 2.2 shtohet pika 2.3 me këtë përmbajtje:

“2.3 Inspektorati Shtetëror Përgjegjës, sipas nevojave të rastit, vendos marrjen e masave urgjente, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për inspektimin.”.

4. Shkronja “a” e pikës 3 shfuqizohet.

5. Në shkronjën “b” të pikës 3, numri “90” zëvendësohet me numrin “100”.

6. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Shqyrtimi, marrja e vendimit përfundimtar dhe ankimi ndaj vendimit të inspektoratit bëhen në përputhje me ligjin për inspektimin. Ekzekutimi i këtyre gjobave bëhet sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.”.

Neni 4

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7971, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ

Nr. 13/2013

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8734, DATË 1.2.2001 “PËR GARANTIMIN E SIGURISË SË PUNËS TË PAJISJEVE DHE TË INSTALIMEVE ELEKTRIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8734, datë 1.2.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2 pika 2 dhe kudo në ligj emërtimi “Inspektorati Qendror Teknik” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati Shtetëror Përgjegjës për Sigurinë e Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike (në vijim në tekstin e ligjit Inspektorati)” dhe shkurtimet “IQT” e “IPIE” zëvendësohen me fjalën “Inspektorati”.

Neni 2

Në nenin 2 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. “Vendosje në treg” ka të njëjtin kuptim si edhe në ligjin nr. 10 489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”. ”.

2. Në pikën 3 fjala “thelbësore” hiqet.

3. Në pikën 4, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) Instalime të tensionit të ulët, të projektuara për tension alternativ 50 – 1 000 volt dhe për tension të vazhduar 75 – 1 500 volt.”.

4. Kudo në këtë nen emërtimi “Inspektorati Shtetëror i Punës” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati shtetëror që mbulon fushën e punës”.

Neni 3

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 3

Kërkesat e sigurisë

1. Pajisjet, instalimet dhe rrjetet elektrike duhet të plotësojnë kërkesat e sigurisë, të përcaktuara në rregulloret në fuqi të projektimit, përdorimit, shfrytëzimit dhe vlerësimit të konformitetit.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë rregullat teknike në zbatim të pikës 1 të këtij neni.”.

Neni 4

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 4

Vendosja në treg/në shfrytëzim

Pajisjet dhe materialet elektrike lejohen të vendosen në treg dhe të vihen në shfrytëzim vetëm nëse nuk rrezikojnë sigurinë e njerëzve dhe, kur është rasti, të kafshëve shtëpiake ose të vlerave materiale.”.

Neni 5

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 5

Mbikëqyrja dhe heqja nga tregu

1. Kur inspektori vëren se një pajisje ose instalim elektrik, i përcaktuar sipas nenit 2 dhe i përdorur në përputhje me destinimin e saj, rrezikon sigurinë e njerëzve dhe, kur është rasti, të kafshëve shtëpiake ose të vlerave materiale, merr masat urgjente të nevojshme për të hequr pajisjen ose instalimin nga tregu dhe nga shfrytëzimi, si dhe çdo masë tjetër urgjente, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

2. Ankimi ndaj vendimit që vendos marrjen e masës urgjente bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin.”.



Neni 6

Në nenin 6 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2, fjalët “Ministria përgjegjëse” zëvendësohen me fjalët “Këshilli i Ministrave”.
2. Në pikën 5, shkronja “c” shfuqizohet.

Neni 7

Në nenin 9, shkronja “a” e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“a) Përdorimi i pajisjeve elektrike bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, të lëshuar nga një organ i akredituar certifikues personeli për fushën përkatëse.”.

Neni 8

Titulli i kreut III bëhet “Inspektorati që mbulon fushën e pajisjeve dhe instalimeve elektrike”.

Neni 9

Në nenin 14, shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2 ndryshohen si më poshtë:

- a) cakton detyra dhe afate për mënjanimin e shkeljeve;
- b) pezullon veprimtarinë për një periudhë të caktuar kohe ose e pushon atë përgjithmonë, kur gjykon se një pajisje ose instalim elektrik nuk garanton sigurinë;”.

Neni 10

Në nenin 17 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, pas fjalës “gjobë” shtohen fjalët “si dënim kryesor”.
2. Pikat 3, 4 dhe 5 ndryshohen si më poshtë:
 - “3. Mënyra e llogaritjes së gjobës bëhet sipas rregullores së metodologjisë së përcaktimit të dënimeve, të miratuar në përputhje me ligjin për inspektimin.
 4. Inspektorati, që mbulon fushën e sigurisë së instalimeve dhe pajisjeve elektrike, vendos gjobën në përputhje me ligjin për inspektimin.
 5. Shqyrtimi, marrja e vendimit përfundimtar dhe ankimi ndaj vendimit të inspektorit bëhen në përputhje me ligjin për inspektimin.”.
3. Pika 6 shfuqizohet.

Neni 11

Në nenin 18, paragrafi i dytë i pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“Pas kalimit të këtij afati, për çdo ditë vonesë paguhet një kamatë prej 2 për qind deri në 30 ditë. Kur pas këtij afati gjoba nuk paguhet, zbatohet legjislacioni në fuqi për kundërvajtjet administrative.”.

Neni 12

Dispozitë kalimtare

1. Deri një vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, detyrat e organit të akredituar certifikues të personelit, sipas nenit 9 të ligjit, mund të kryhen nga një komision i miratuar nga ministri përgjegjës për energjinë, anëtarët e të cilit duhet të jenë inxhinierë elektrikë me eksperiencë pune 15-vjeçare në fushën e montimit dhe mirëmbajtjes së impianteve, instalimeve dhe objekteve elektro-energjetike.

2. Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7972, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

**LIGJ
Nr. 14/2013**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9875, DATË 14.2.2008 “PËR
METROLOGJINË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9875, datë 14.2.2008 “Për metrologjinë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në ligj fjalët “Metrologu i autorizuar” zëvendësohen me fjalët “Metrologu i miraturar”, fjalët “Inspektorit metrolog” zëvendësohen me fjalën “Inspektor” dhe emërtimi “Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë” zëvendësohet me fjalën “Inspektori”.

Neni 2

Në nenin 3, pika 24 ndryshohet si më poshtë:

“24. “Inspektimi metrologjik” është kontrolli që ushtrohet në lidhje me vendosjen në treg dhe përdorimin e instrumenteve matëse që kryhet me qëllim për të provuar që ato janë zbatuar/përdorur në mënyrë korrekte, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret që i përkasin. Ai përfshin dhe kontrollin e korrektësisë së sasisë së treguar dhe përmbajtjes në parapaketime tashmë të vendosura në treg.”.

Neni 3

Në nenin 6, pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) Inspektorati që mbulon fushën e metrologjisë.”.

Neni 4

Pas nenit 7 shtohet neni 7/1 me këtë përmbajtje:



“Neni 7/1

**Organizimi dhe funksionimi i inspektoratit që mbulon
fushën e metrologjisë**

1. Inspektorati që mbulon fushën e metrologjisë është organi i vetëm i ngarkuar me kryerjen e funksioneve të inspektimit metrologjik në zbatim të këtij ligji dhe dispozitave të tjera në fuqi.

2. Organizimi dhe funksionimi i këtij inspektorati përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 5

Në nenin 8 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 10 ndryshohet si më poshtë:

“10. Kryen miratimin dhe monitorimin e sistemeve të kontrollit sasior të prodhuesve të parapaketimeve dhe shisheve enëmatëse.”.

2. Pikat 13 dhe 14 shfuqizohen.

Neni 6

Pas nenit 8 shtohet neni 8/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 8/1

Detyrat dhe kompetencat e Inspektoratit

Inspektorati që mbulon fushën e metrologjisë, krahas kompetencave që përcaktohen në nenet e tjera të këtij ligji, kryen detyrat dhe kompetencat, si më poshtë:

a) kryen inspektim metrologjik;

b) merr vendim për heqjen nga tregu të instrumentit matës, kur ky instrument nuk plotëson kërkesat teknike dhe metrologjike të kërkuara, të përcaktuara për një procedurë testimi;

c) kryen detyra të tjera, në kuadër të përmbushjes së funksionit të inspektimit sipas përcaktimit të këtij ligji.”.

Neni 7

Në nenin 22 pikat 2 dhe 3, fjalët “apo heqjen” dhe “ose heqjen” hiqen.

Neni 8

Në nenin 23 pika 1, fjala “testuese” zëvendësohet me fjalët “të vlerësimit të konformitetit”.

Neni 9

Në nenin 37, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Prodhuesi ose importuesi, kur konstatohet se parapaketimet ose shishet enëmatëse të hedhura në treg prej tij nuk përmbushin kërkesat ligjore të përshkruara, është i detyruar që, në bashkëpunim me inspektoratin që mbulon fushën e metrologjisë, të marrë masat e duhura për mbrojtjen e konsumatorit.”.

Neni 10

Neni 47 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 47

Inspektimi metrologjik

Inspektimi metrologjik bëhet nga inspektorati që mbulon fushën e metrologjisë në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për inspektimin.”.

Neni 11

Në nenin 49 bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 1 dhe 2 shfuqizohen.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Personat juridikë apo fizikë, veprimtaritë e të cilëve janë subjekt i inspektimit, janë të detyruar të ndihmojnë inspektorin dhe t’i japin atij të dhënat e domosdoshme që lidhen me objektin e inspektimit. Me kërkesë me shkrim të inspektorit, subjekti i inspektimit është i detyruar të japë ose të përgatitë brenda një periudhe të caktuar të dhëna të plota dhe të sakta, informacione dhe regjistrime të nevojshme për kryerjen e inspektimit.”.

3. Pikat 4 dhe 5 shfuqizohen.

Neni 12

Në nenin 50 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronjat “a”, “c”, “dh” dhe “ë” të pikës 1 shfuqizohen.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Në rastet kur inspektori vëren shkelje të këtij ligji dhe të rregulloreve të miratuara merr masat urgjente, sipas nevojave të rastit, vendos dënimin kryesor dhe mund të vendosë një ose disa nga dënimet plotësuese.

2.1. Dënime kryesore janë:

a) urdhërimi i korrigjimit të parregullsive dhe të mangësive të vërejtura brenda një periudhe kohe të specifikuar;

b) dënim me gjobë, i cili vendoset për të gjitha shkeljet e konstatuara, në përputhje me nenin 64 të këtij ligji.

2.2. Dënime plotësuese janë:

a) pezullimi i përdorimit të instrumenteve matëse dhe pezullimi i hedhjes në treg të parapaketimeve dhe shisheve enëmatëse, që nuk përputhen me kërkesat e përshkruara;

b) pezullimi i kryerjes së veprimtarive, që janë në kundërshtim me ligjin apo me rregullat e zbatuara;

c) plumbosja;

ç) vendimi për ndalimin e hedhjes në treg apo heqjes nga tregu të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara.

2.3. Masa urgjente janë masat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për inspektimin.”.

Neni 13

Pas nenit 56 shtohet neni 56/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 56/1

Plumbosja si dënim plotësues

Plumbosja si dënim plotësues vendoset nga inspektorati që mbulon fushën e metrologjisë për rastet kur, në bazë të këtij ligji ose të ligjeve të tjera, parashikohet detyrimi për pumbosje, sipas procedurave të përcaktuara në dispozitat në fuqi.”.



Neni 14

Në nenin 58, pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

“1. Kur parregullsitë e vërejtura nuk janë korrigjuar brenda periudhës kohore të specifikuar dhe para se parapaketimet dhe shishet enematëse të hidhen në treg, inspektori mund të nxjerrë një vendim për ndalimin e hedhjes në treg të parapaketimeve.

2. Kur parregullsitë e vërejtura në instrumentet matëse ligjërisht të kontrolluara, që janë në treg ose në përdorim, nuk janë korrigjuar brenda periudhës kohore të specifikuar, inspektori merr vendim për bllokimin, largimin nga tregu ose ndalimin e përdorimit të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara.”.

Neni 15

Në nenin 64, shkronja “d” e pikës 1 dhe shkronjat “a” dhe “c” të pikës 2 shfuqizohen.

Neni 16

Neni 65 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 65

Shqyrtimi dhe ankimi

Shqyrtimi, marrja e vendimit përfundimtar dhe ankimi ndaj vendimit të inspektorit bëhen në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 17

Nenet 48, 52, 53, 54, 55, 57, 60 dhe 61 shfuqizohen.

Neni 18

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7973, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ
Nr. 15/2013

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9902, DATË 17.4.2008 “PËR
MBROJTJEN E KONSUMATORËVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Kudo në ligj fjalët “Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut” zëvendësohen me fjalët “Inspektorati përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut”, ndërsa në nenin 57 zëvendësohen me fjalët “Inspektori i inspektoratit përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut” dhe emërtimi “Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati që mbulon fushën e metrologjisë”.

Neni 2

Në nenin 51, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Kontrolli i respektimit të kërkesave ligjore, sipas këtij ligji, bëhet në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. ”.

Neni 3

Në nenin 57, pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Gjobat e vendosura sipas këtij neni janë dënime kryesore.”.

Neni 4

Nenit 58 i shtohet titulli “Gjobat e komisionit”.

Neni 5

Pas nenit 58 shtohet neni 58/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 58/1

Shqyrtimi dhe ankimi i gjobave

Gjobat e vendosura nga inspektorët, sipas nenit 57 të këtij ligji, shqyrtohen, merren përfundimisht dhe ankimohen në përputhje me ligjin për inspektimin.”.



Neni 6

Titulli i nenit 59 ndryshohet si më poshtë:
“Procedura e ankimit ndaj vendimeve të komisionit”.

Neni 7

Në nenin 59, pika 2 shfuqizohet.

Neni 8

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7974, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ

Nr. 16/2013

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 10 480, DATË 17.11.2011 “PËR SIGURINË E PËRGJITHSHME TË PRODUKTEVE JOUSHQIMORE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 480, datë 17.11.2011 “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Përveçse kur parashikohet drejtpërdrejt nga ligji, strukturat përgjegjëse për kryerjen e funksioneve të mbikëqyrjes së tregut sipas produkteve apo grup produkteve, miratohen apo përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

2. Pas pikës 2 shtohen pikat 3 dhe 4 me këtë përmbajtje:

“3. Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut i ushtron përgjegjësitë e veta në zbatim të këtij ligji, në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë ligj.

4. Procedurat standarde operacionale të veprimtarisë së mbikëqyrjes së tregut, të detyrueshme për të gjitha strukturat e mbikëqyrjes së tregut, miratohen me urdhër të ministrit.”.

Neni 2

Në nenin 11, pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Krahas masave të parashikuara në këtë nen dhe në nenin 10 të këtij ligji, struktura përgjegjëse merr çdo masë tjetër urgjente të nevojshme, në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 3

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 13

Vendime për riskun serioz

Këshilli i Ministrave nxjerr vendime për ndalimin e tregtimit, importit ose/dhe eksportit për ato produkte që paraqesin risk të lartë e serioz për shëndetin dhe sigurinë e konsumatorëve, në rastet kur ka evidenca shkencore ose/dhe faktike për natyrën serioze të riskut, që kërkon ndërhyrje të menjëhershme në nivel kombëtar të mënjanimit të tij.”.

Neni 4

Në nenin 25, pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Gjoha është dënim kryesor dhe ajo mund të shoqërohet edhe me një apo disa dënime plotësuese, të përcaktuara në nenet 10 dhe 11 të këtij ligji.”.

Neni 5

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 26

Shqyrtimi i shkeljeve

Shkeljet me karakter administrativ shqyrtohen dhe dënohen nga struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, në përputhje me dispozitat në fuqi.”.

Neni 6

Nenet 27 dhe 31 shfuqizohen.

Neni 7

Neni 28 ndryshohet si më poshtë:



**“Neni 28
Ankim**

Ndaj vendimit të strukturës përgjegjëse për marrjen e masave të parashikuara në nenet 20 dhe 21, si dhe për marrjen e masave të tjera urgjente mund të bëhet ankim i veçantë, sipas ligjit për inspektimin.

Kundër vendimit të strukturës përgjegjëse për dënimin kryesor me gjobë dhe dënimeve plotësuese, mund të bëhet ankim në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 8

Neni 29 ndryshohet si më poshtë:

**“Neni 29
Ekzekutimi i vendimit të strukturës përgjegjëse**

Ekzekutimi i vendimit bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin dhe për kundërvajtjet administrative.”.

**Neni 9
Dispozitë kalimtare**

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7975, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

**LIGJ
Nr. 17/2013**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 489, DATË 15.12.2011 “PËR TREGTIMIN DHE
MBIKËQYRJEN E TREGUT TË PRODUKTEVE JOUSHQIMORE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 18 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, shkronja “ç” ndryshohet si më poshtë:

“ç) informon menjëherë ministrin përgjegjës për çdo veprimtari të vlerësimit të konformitetit, duke siguruar kopje të certifikatave, raporteve të testimit dhe të vlerësimit të konformitetit, përfshirë dokumentet për to dhe informacion për lëshimin, refuzimin ose tërheqjen e certifikatave, si dhe strukturës përgjegjëse dhe autoriteteve të tjera me kërkesë të këtyre të fundit.”.

2. Pas pikës 8 shtohet pika 9 me këtë përmbajtje:

“9. Organi i miratuar për qëllime të inspektimit periodik të produkteve/instalimeve të vëna në shërbim informon menjëherë ministrin përgjegjës për listën e planifikimit të inspektimeve periodike dhe çdo ndryshim të saj.”.

Neni 2

Në nenin 19, në fund të pikës 2 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Organizmi Kombëtar i Akreditimit njofton paraprakisht ministrin përgjegjës për çdo vizitë vlerësuese pranë organit të vlerësimit të konformitetit, i cili ka aplikuar për akreditim për qëllime miratimi.”.

Neni 3

Neni 38 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 38

Marrja e vendimit

Personi përgjegjës, që ka kryer kontrollin, merr vendim në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 4

Neni 39 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 39

Ankimi

Kundër vendimit të Inspektoratit lejohet ankim në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 5

Neni 40 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 40

Ekzekutimi i vendimit

Ekzekutimi i vendimeve, sipas këtij ligji, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.”.



Neni 6
Dispozitë kalimtare

1. Deri një vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, inspektimi i rregullt periodik, sipas nenit 16 të ligjit, mund të kryhet nga organet e akredituara në këtë fushë.

2. Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7976, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ
Nr. 18/2013

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8681, DATË 2.11.2000 “PËR
PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN, SHFRYTËZIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E DIGAVE DHE
DAMBAVE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8681, datë 2.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas nenit 4 shtohet neni 4/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 4/1
Inspektimi

Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, sipas këtij ligji, bëhet në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. ”.

Neni 2

Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

**“Neni 11
Sanksione**

Përveç detyrimeve që përmbajnë këto dispozita, shkelje dhe kryerje të veprimeve të kundërligjshme, të cilat përbëjnë kundërvajtje në fushën e digave/dambave, dënohen me dënim kryesor me gjobë:

- a) për nenin 6, me shumën 500 000 lekë;
- b) për nenet 5 dhe 9, me shumën 100 000 lekë.

Gjobat vendosen nga Inspektorati Teknik i Digave/Dambave.

Krahas dënimit kryesor, inspektori ka të drejtë të marrë masa urgjente në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 3

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 12

Kundër vendimit të Inspektoratit Teknik të Digave/Dambave mund të bëhet ankim te KKDM-ja, sipas Kodit të Procedurave Administrative.

Kundër vendimit të KKDM-së mund të bëhet ankim në përputhje me ligjin për inspektimin.

Ekzekutimi i këtyre gjobave bëhet sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

Gjobat paguhen në zyrën e financës së organit të kontrollit.”.

**Neni 4
Dispozitë kalimtare**

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7977, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**



LIGJ
Nr. 19/2013

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9290, DATË 7.10.2004 “PËR
PRODUKTET E NDËRTIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9290, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3, pas pikës 16 shtohet pika 17 me këtë përmbajtje:

“17. “Inspektim” është çdo lloj forme kontrolli për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, i kryer në zbatim të këtij ligji dhe në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë””.

Neni 2

Në nenin 20, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Masat e parashikuara në shkronjat “ç”, “d”, “dh” dhe “e” të këtij neni janë masa urgjente dhe mund të vendosen krahas masave urgjente që parashikon ligji për inspektimin.”.

Neni 3

Në nenin 21, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Ankimi kundër vendimeve të marra, në përputhje me pikën 2 të nenit 20, bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin dhe nuk e pezullon zbatimin e tyre.”

Neni 4

Në nenin 23 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Gjobat vendosen nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar dhe janë dënim administrativ kryesor.”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Shqyrtimi, marrja e vendimit përfundimtar dhe ankimi ndaj vendimit me gjobë bëhen në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 5

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7978, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

**LIGJ
Nr. 20/2013**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8402, DATË 10.9.1998 “PËR KONTROLLIN DHE
DISIPLINIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 1

Projektimi, mbikëqyrja, zbatimi dhe kolaudimi i punimeve për objektet në Republikën e Shqipërisë kontrollohen dhe disiplinojnë në bazë të dispozitave të këtij ligji.

Kontrolli për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, të parashikuara në këtë ligj, bëhet nga struktura përkatëse në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. ”.

Neni 2

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 15

1. Shkeljet e neneve 4, 5, 6, 7 e 8 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me dënim kryesor, me gjobë në masën 50 000 deri në 2 000 000 lekë.

2. Shkeljet e neneve 9, 10 e 11 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me dënim kryesor, me gjobë në masën 50 000 deri në 500 000 lekë.



3. Shkeljet e neneve 12 e 14 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me dënim kryesor, me gjobë në masën 500 000 deri në 5 000 000 lekë.

4. Gjobat vendosen nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik i Bashkisë/Komunës/Qarkut, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për inspektimin.

5. Për moszbatimin e detyrimeve, të përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji, përveç dënimit kryesor me gjobë, Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik i Bashkisë/Komunës/Qarkut u paraqet organeve përkatëse kërkesën për heqjen e licencës së mbikëqyrësit të punimeve.”.

Neni 3

Neni 17 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 17

Kundër vendimit të Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik të Bashkisë/Komunës/Qarkut lejohet ankim në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 4

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7979, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ

Nr. 21/2013

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8308, DATË 18.3.1998 “PËR TRANSPORTET RRUGORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 64 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore bëhet në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë””.

Neni 2

Neni 65 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 65

Personat e ngarkuar me detyrën e kontrollit/inspektimit shtetëror janë të autorizuar nga organi i specializuar i kontrollit dhe pajisen me dokumentin përkatës të identitetit si kontrollor/inspektor. Ata e ushtrojnë veprimtarinë sipas këtij ligji, duke verifikuar të gjithë dokumentacionin dhe evidencat që i takojnë transportit rrugor.”.

Neni 3

Neni 70 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 70

Kundërvajtjet administrative konstatohen, shqyrtohen dhe ndëshkohen nga personat e ngarkuar me detyrën e kontrollit/inspektimit shtetëror të transportit, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin për inspektimin.

Ndaj vendimit që konstaton kundërvajtjen administrative mund të bëhet ankim në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 4

Paragrafi i dytë i nenit 71 dhe neni 72 shfuqizohen.

Neni 5

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7980, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**



LIGJ
Nr. 22/2013

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 10 119, DATË 23.4.2009 “PËR
PLANIFIKIMIN E TERRITORIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 81, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, sipas këtij ligji, bëhet në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë””.

Neni 2

Në nenin 82, pas pikës 11 shtohet pika 12 me këtë përmbajtje:

“12. Masa e gjobës dhe masat e parashikuara në pikën 8 të nenit 83 dhe masa e pezullimit ose e ndërprerjes, e parashikuar në këtë ligj, janë dënime kryesore. Sipas nevojave të rastit, organi i kontrollit mund të caktojë masat e parashikuara në pikën 8 të nenit 83 edhe si dënime plotësuese.”.

Neni 3

Në nenin 83, pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Procedurat e konstatimit të kundërvajtjes, të njoftimit të kundërvajtësit, vendimit, ankimit dhe masave të tjera administrative, kundrejt shkeljeve të këtij ligji, rregullohen sipas dispozitave në fuqi për inspektimin e ndërtimit, dispozitave të këtij ligji dhe ligjit për inspektimin.”.

Neni 4

Neni 86 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 86

Ankimi administrativ dhe gjyqësor

1. Çdo person ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj. Në përfundim të ankimit administrativ, bëhet ankim në gjykatë.

2. Për procedurat e ankimit, sipas këtij neni, zbatohen rregullat dhe afatet e parashikuara në ligjin për inspektimin.”.

Neni 5
Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7981, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ
Nr. 23/2013

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9780, DATË 16.7.2007 “PËR
INSPEKTIMIN NË NDËRTIM”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin në ndërtim”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 4 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, sipas këtij ligji, bëhet në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë””.

Neni 2

Në fund të nenit 5 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Masa e pezullimit të punimeve dhe e prishjes së ndërtimit të kundërligjshëm mund të vlerësohen nga inspektorati përkatës, sipas nevojave të rastit, si dënim kryesor ose dënim plotësues. Ndërsa masa e vendimit për zhdëmtim është dënim plotësues.”.

Neni 3

Nenet 12 dhe 13 shfuqizohen.



Neni 4

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 14

Ankimi administrativ dhe gjyqësor

Kundër vendimit të Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik të Bashkisë/Komunës/Qarkut/Kombëtar për marrjen e masave urgjente dhe dhënien e sanksioneve administrative mund të bëhet ankim në përputhje me ligjin për inspektimin. Në rast se në bazë të vendimit përfundimtar të formës së prerë të gjykatës, vendoset pranimi i padisë, i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik i Bashkisë/Komunës/Qarkut/Kombëtar që ka dhënë vendimin, dëmshpërblimin për dëmin e shkaktuar.”.

Neni 5

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7982, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ

Nr. 24/2013

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9634, DATË 30.10.2006 “PËR INSEKTIMIN E PUNËS DHE INSEKTORATIN SHTETËROR TË PUNËS”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9634, datë 30.10.2006 “Për inspektimin e punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Titulli i ligjit bëhet “Për inspektimin e punës”.

Neni 2

Kudo në ligj, emërtimi “Inspektorat Shtetëror i Punës” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati shtetëror që mbulon fushën e punës”, emërtimi “Inspektor i përgjithshëm” zëvendësohet me emërtimin “Kryeinspektor”, emërtimi “Drejtoria e Përgjithshme e Inspektoratit të Punës” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati shtetëror që mbulon fushën e punës”, emërtimi “Inspektori i Përgjithshëm”, përveç nenit 29, zëvendësohet me emërtimin “Kryeinspektori i Inspektoratit Shtetëror që mbulon fushën e punës”, ndërsa fjalët “të pajisur me kartën e legjitimitetit nga ministri” hiqen.

Neni 3

Në nenin 2 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pikat 1, 2 dhe 6 ndryshohen si më poshtë:

“1. “Inspektorat” është inspektorati shtetëror që mbulon fushën e punës, organizimi dhe funksionimi i të cilit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

2. “Inspektim në punë” është çdo formë kontrolli për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, sipas legjislacionit të punës, i bërë nga inspektorati, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin për inspektimin.

6. “Inspektor pune” është inspektori i inspektoratit shtetëror që mbulon fushën e punës.”.

2. Pikat 16, 17 dhe 18 shfuqizohen.

Neni 4

Në nenin 13 pika 1 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Në rast të kryerjes së inspektimit pa njoftim paraprak, inspektori dhe kontrollori i punës është i detyruar të respektojë edhe kërkesat e ligjit për inspektimin.”.

Neni 5

Në nenin 14, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Të verifikojnë regjistrat apo dokumentet e tjera dhe të bëjnë kopjet e tyre, kur e shohin të arsyeshme. Marrja e kopjeve, sekuestrimi i dokumenteve dhe trajtimi i informacionit, që pasqyrohet në to, bëhen në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 6

Në nenin 15, fjalët “janë të autorizuar të urdhërojnë marrjen e masave të menjëhershme” zëvendësohen me fjalët “vendosin masa urgjente”.

Neni 7

Neni 16 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 16

Mbrojtja e kontrollit të punës

Gjatë ushtrimit të detyrave të tij, kontrollori i punës gëzon të njëjtën mbrojtje ligjore sikurse inspektori, në përputhje me ligjin për inspektimin.”.



Neni 8

Neni 29 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 29

Përmbajtja e raportit

Rregullat e përgjithshme për përmbajtjen e raportit dhe procesin e raportimit përcaktohen nga Inspektori i Përgjithshëm, në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 9

Në nenin 33, pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Gjoha është dënim kryesor.”.

Neni 10

Neni 34 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 34

Ankimi dhe ekzekutimi

“1. Shqyrtimi, marrja e vendimit përfundimtar dhe ankimi ndaj vendimit të inspektorit bëhen në përputhje me ligjin për inspektimin.

2. Ekzekutimi i këtyre gjobave bëhet sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

3. Gjobat derdhen në Buxhetin e Shtetit.”.

Neni 11

Neni 35 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 35

Pezullimi i punimeve

1. Në rastet e shkeljeve flagrante të pikës 1 shkronja “dh” dhe të pikës 2 shkronja “ç” të nenit 15 të këtij ligji, inspektori i punës vendos masën urgjente të pezullimit të punës.

2. Marrja e pezullimit si masë urgjente ose vendosja e tij si dënim plotësues bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin.

3. Ankimi ndaj vendosjes së masës urgjente të pezullimit ose vendosjes së pezullimit si dënim plotësues bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 12

Nenet 7, 8, 9, 10, 30, 31 pika 2 dhe 36 shfuqizohen.

Neni 13

Në nenin 40, referenca në nenet 8 dhe 30 shfuqizohet.

Neni 14
Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 15
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7983, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ
Nr. 25/2013

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 9355, DATË 10.3.2005
“PËR NDIHMËN DHE SHËRBIMET SHOQËRORE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në ligj emërtimi “Inspektorati i Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe Shërbimeve Shoqërore” zëvendësohet me emërtimin “struktura përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike, pagesën për personat me aftësi të kufizuara”.

Neni 2

Në nenin 26, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Ministri përgjegjës për çështjet e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore ngre strukturën përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike dhe pagesën për personat me aftësi të kufizuara, e cila kontrollon veprimtarinë dhe zbatimin e legjislacionit në strukturat dhe institucionet në varësi të tij dhe seksionet e ndihmës ekonomike në bashki ose komuna, si dhe miraton dokumentacionin e përcaktuar në nenin 27 pika 5 shkronja “c” të këtij ligji.”.



Neni 3

Në nenin 27, pas pikës 5 shtohen pikat 6 dhe 7 me këtë përmbajtje:

“6. Kontrolli për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shërbimeve shoqërore bëhet nga inspektorati që mbulon këtë fushë, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

7. Organizimi dhe funksionimi i inspektoratit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 4

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7984, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ

Nr. 26/2013

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8025, DATË 9.11.1995 “PËR MBROJTJEN NGA RREZATIMET JONIZUESE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 7, shkronja “g” ndryshohet si më poshtë:

“g) Bashkëpunon me inspektoratin që mbulon fushën e punës dhe me inspektoratin që mbulon fushën e shëndetit.”.

Neni 2

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 8

Organet që kryejnë verifikimin e respektimit të kërkesave të këtij ligji

1. Zyra e mbrojtjes nga rrezatimet ka këto detyra e të drejta:
 - a) Paraqet për miratim në komision aktet rregulluese të veprimtarisë së mbrojtjes nga rrezatimet.
 - b) Kontrollon në praktikë zbatimin e akteve ligjore e nënligjore në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet.
 - c) Kryen inspektimin e instalimeve dhe veprimtarive me rrezatim, në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.
 - ç) Mbledh informacion dhe kryen matjet e analizat e nevojshme për kontrollin e mbrojtjes nga rrezatimet.
 - d) Përgatit dosjet për dhënien, pezullimin dhe heqjen e licencave dhe ia paraqet komisionit për miratim.
 - dh) Përgatit materialet e mbledhjeve të komisionit, si dhe raportet e kërkuara prej tij.
 - e) Mban inventarin kombëtar të burimeve të rrezatimit jonizues.
2. Këshilli i Ministrave përcakton rastet kur inspektorati që mbulon fushën e shëndetit kryen inspektime për zbatimin e rregullave të instalimeve apo veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues, si dhe të mënyrës së bashkëpunimit të tij me Zyrën e Mbrojtjes nga Rrezatimi.”.

Neni 3

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 10

Shkelja e dispozitave të parashikuara në nenet 4 e 5 të këtij ligji, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me dënim kryesor, me gjobë nga 100 000 lekë deri në 300 000 lekë. Krahas dënimit me gjobë, inspektori mund të marrë masa urgjente.

Gjobat dhe masat urgjente vendosen dhe shqyrtohen nga inspektorët e organeve që kryejnë verifikimin e respektimit të kërkesave të këtij ligji, sipas nenit 8, si dhe në përputhje me ligjin për inspektimin.

Ankimi ndaj dënimit me gjobë dhe masave urgjente bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin.

Ekzekutimi i dënimit me gjobë bëhet në përputhje me dispozitat në fuqi për kundërvajtjet administrative, ndërsa ekzekutimi i masave urgjente bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 4

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7985, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**



LIGJ
Nr. 27/2013

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 469, DATË 13.10.2011 “PËR MBROJTJEN NGA RREZATIMET JOJONIZUESE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 469, datë 13.10.2011 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese” bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 5

Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet

Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet është autoriteti përgjegjës kombëtar rregullator, që mbikëqyr dhe siguron zbatimin e dispozitave të këtij ligji e të akteve të tjera ligjore e nënligjore në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jojonizuese, i cili është ngritur dhe funksionon sipas parashikimeve të ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet përcakton masat e nevojshme për të siguruar në çdo rast që ekspozimet e çdo instalimi ose pajisjeje që emeton rrezatim jojonizues të jenë në përputhje me normat e miratuara nga rregulloret përkatëse.”.

Neni 2

Në nenin 6 bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) kontrollon zbatimin në praktikë të akteve ligjore e nënligjore për mbrojtjen nga rrezatimi jojonizues, në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë””.

2. Pas shkronjës “f” shtohet shkronja “g” me këtë përmbajtje:

“g) bashkëpunon me inspektoratin që mbulon fushën e punës dhe me inspektoratin që mbulon fushën e shëndetit.”.

Neni 3

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 7

Organet që kryejnë verifikimin e respektimit të kërkesave të këtij ligji

1. Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet është njësi ekzekutive e Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet, e cila, përveç detyrave të përcaktuara në fushën e rrezatimit jonizues, kryen edhe këto detyra:

a) Paraqet për miratim në komision aktet rregulluese të veprimtarisë së mbrojtjes nga rrezatimet jojonizuese;

b) Kontrollon në praktikë dhe mbikëqyr zbatimin e akteve ligjore e nënligjore në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jojonizuese;

c) Kryen inspektimin e instalimeve dhe veprimtarive me rrezatim jojonizues, në përputhje me ligjin për inspektimin;

ç) Mbledh informacion dhe kryen matjet bazë e analizat e nevojshme për kontrollin e mbrojtjes nga rrezatimet jojonizuese;

d) Përgatit dosjet për miratimin e veprimtarive me burime të rrezatimit jojonizues;

dh) Përgatit materialet e mbledhjeve të komisionit, si dhe raportet e kërkuara prej tij;

e) Mban inventarin për të gjitha matjet e kryera kombëtare të instalimeve dhe regjistrat e posaçëm për të gjitha matjet e kryera.

2. Këshilli i Ministrave përcakton rastet kur inspektorati që mbulon fushën e shëndetit kryen inspektime për zbatimin e rregullave të instalimeve apo veprimtarive me burime të rrezatimit jojonizues, si dhe të mënyrës së bashkëpunimit të tij me Zyrën e Mbrojtjes nga Rrezatimi.”.

Neni 4

Në nenin 9, pikat 2, 3, 4 dhe 5 ndryshohen si më poshtë:

“2. Gjobat e vëna në zbatim të këtij ligji vendosen dhe shqyrtohen nga inspektorët e organeve që kryejnë verifikimin e respektimit të kërkesave të këtij ligji, sipas nenit 7 dhe në përputhje me ligjin për inspektimin si dhe janë dënime kryesore për qëllime të zbatimi të ligjit për inspektimin.

3. Inspektori përkatës, sipas nevojave të rastit, vendos masa urgjente në përputhje me ligjin për inspektimin.

4. Ankimi ndaj dënimit me gjobë dhe masave urgjente bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin.

5. Ekzekutimi i dënimit me gjobë bëhet në përputhje me dispozitat në fuqi për kundërvajtjet administrative, ndërsa ekzekutimi i masave urgjente bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 5

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7986, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 11.3.2013
Doli nga shtypi më 11.3.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 52 lekë